



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SE KONSUMATORIT  
MINISTRI

Nr. 186 Prot

Tirane, më 16.04 2012

UDHËZIM

Nr. 5 Datë 16.04 2012

**“PËR SASITË E TREGTUESHME TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR, VARIETETI I TË CILIT ËSHTË NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR, SI DHE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKËSES PËR AUTORIZIMIN E IMPORTIT TË MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË ÇERTIFIKUAR JO PËRFUNDIMISHT OSE NË PROCES REGJISTRIMI NË KATALOGUN KOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 6, pikës 4 të nenit 10 dhe pikës 4 të nenit 26 të Ligjit Nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Bujqësore dhe Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve,

UDHËZOJ

**I. Rregullat që përcaktohen**

1. Në këtë udhëzim përcaktohen:

1.1 Sasitë e tregtueshme të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në Katalogun Kombëtar (KK) si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkeses për autorizimin e importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të çertifikuar jo përfundimisht ose në proces regjistrimi në KK.

1.2 Sasitë maksimale të mostrave të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për speciet e bimëve, të destinuara për:

- testim varietor dhe për kontrollë zyrtare mbikqyrese;
- qëllime shkencore për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik

## **II. Rregullat për lejimin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK**

1. Për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti i cili është në proces pranimi për regjistrim në KK, subjekti duhet të paraqesë kërkesë pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (**ESHFF**) sipas modelit të pasqyruar në Aneksi 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.
2. Lejimi i tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces regjistrimi në KK, bëhet vetëm për ato specie të cilat ndodhen në tabelën e Aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi;
3. Subjekti i interesuar duhet të shoqërojë kërkesën e tij me dokumentacionin i cili provon vlerën për kultivimin dhe përdorimin e varieteteve në momentin e dorëzimit të mostrave për ekzaminim të varietetit, si dhe me dokumentacionin i cili duhet të përmbajë edhe të dhënat e më poshtme:
  - specia;
  - varieteti;
  - përshkrimin agrobiologjik të varietetit;
  - kërkesat e varietetit për kushtet, klimatike dhe tokësore.
4. Subjekti i cili paraqet kërkesën, si dhe materiali mbjellës dhe shumëzues bimor mbi të cilin paraqitet kërkesa, duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera për tregtim të përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”;
5. Afati maksimal i lejimit të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të një varieteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK është 3 (tre) vjet.
6. Subjekti të cilit i lejohet të tregtojë materialin në proces regjistrimi në KK, duhet ta identifikojë në mënyrë të dukshme dhe të qartë këtë material, pranë çdo vëndi të tregtimit të tij, me shënimin “*varietet në proces regjistrimi në KK*”.

## **III. Rregullat për autorizimin e veçantë për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të çertifikuar jo përfundimisht ose të një varieteteti që është në proces pranimi për regjistrim në KK**

1. Për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të çertifikuar jo përfundimisht dhe /ose të një varieteti i cili është në proces pranimi për regjistrim në KK, subjekti duhet të paraqesë një kërkesë për autorizim të veçantë pranë ESHFF, sipas modelit të pasqyruar në Aneksin 3, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

## **IV. Sasia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor që nuk konsiderohen produkt për tregtim**

1. Sasia maksimale e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të varieteteve të bimëve bujqësore që konsiderohet mostër për kontrollë zyrtare mbikqyrëse, për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik është dhënë në tabelën e Aneksit 1 të këtij udhëzimi.

2. Mostra të këtij materialit (farë) duhet të shënohet në mënyrë të qartë që është një material i një varieteti të destinuar për qëllim kontrolli zyrtar mbikqyrës, për qëllime shkencore, për punë seleksionuese varietore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik.


3. Dokumentacioni që shoqëron mostrat e materialit mbjellës bimor, krahas destinacionit për qëllime përdorimit të përmbajë dhe të dhënat e mëposhtme:

- specia;
- varieteti;
- sasia e materialit mbjellës
- kategoria (sipas rastit të destinacionit)

#### V. Dispozita të fundit

- ✓ 1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve si dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.



## Sasitë e Materialit mbjellës sipas specieve

Nr	Emri latinisht	Emri shqip	Tregtimi i materialit mbjellës varieteti i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg		mostrat e destinuara për testim varietor kg	mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara
			njesia	sasia		
	1	2	3	4	5	6
I.	<b>Cerealet</b>					
1	<i>Avena sativa</i> L	Tërshëra	ton	10	20	40000
2	<i>Hordeum vulgare</i> L	Elbi	ton	10	20	40000
3	<i>Panicum miliaceum</i> L	Meli	ton	5	20	40000
4	<i>Secale cereale</i> L	Thekra	ton	10	20	40000
5	<i>Sorghum bicolor</i> (L.) Moench	Melakuqja	ton	5	20	40000
6	<i>Sorghum bicolor</i> (L.) Moench X <i>Sorghum sudanense</i> Stapf	Sorgumi sudanez	ton	5	20	40000
7	X <i>Triticum secale</i> Ëittm.	Tritikale	ton	10	20	40000
8	<i>Triticum aestivum</i> L Emend Fiori et Paol	Gruri i butë	ton	20	20	40000
9	<i>Triticum durum</i> Desf	Gruri i fortë	ton	20	20	40000
10	<i>Triticum spelta</i> L.	Tepa	ton	10	20	40000
11	<i>Zea mays</i> L (partim)	Misri	ton	5	5	40000
12	<i>Oryza sativa</i> L	Orizi	ton	10	10	40000
II.	<b>Bimët foragjere</b>					
II.A	<b>Barërat</b>					
1	<i>Agrastis sp</i> L.	Barimëza	ton	1	0.1	40000
2	<i>Alopecurus pratensis</i> L	Bishtdhelpra livadhore	ton	1	0.1	40000
3	<i>Bromus catharticus</i> Vahl	Bromusi	ton	1	0.1	40000
4	<i>Bromus sitchensis</i> Trin	Bromusi i Alaskës	ton	1	0.1	40000
5	<i>Cynodon dactylon</i> (L.) Pers	Grami	ton	1	0.1	40000
6	<i>Dactylis glomerata</i> L	Telishi	ton	1	0.1	40000
7	<i>Festuca arundinacea</i> Schreber	Festuka si kallam	ton	1	0.1	40000
8	<i>Festuca ovina</i> L	Festuka e deleve	ton	1	0.1	40000
9	<i>Festuca pratensis</i> Hudson	Festuka livadhore	ton	1	0.1	40000
10	<i>Festuca rubra</i> L	Festuka e kuqe	ton	1	0.1	40000
11	<i>Lolium multitorum</i> Lam	Lolium shumëlutesh	ton	1	0.1	40000
12	<i>Lolium perenne</i> L	Lolium shumëvjeçar	ton	1	0.1	40000
13	<i>Phleum pratense</i> L	Fleumi livadhore	ton	1	0.1	40000
14	<i>Poa annua</i> L.	Flokësi njëvjeçar	ton	1	0.1	40000
15	<i>Poa nemoralis</i> L	Flokësi i pyjeve	ton	1	0.1	40000
16	<i>Poa palustris</i> L	Flokësi i ligatinave	ton	1	0.1	40000
17	<i>Poa pratensis</i> L	Flokësi livadhore	ton	1	0.1	40000
18	<i>Poa trivialis</i> L.	Flokësi i zakonshëm	ton	1	0.1	40000
19	<i>Trisetum flavescens</i> (L.) P. Beauv	Triseta e zbehtë	ton	1	0.1	40000

M

Nr	Emri latinisht	emri në shqip	Tregtimi i materialit mbjellës		mostrat e destinuarat për testim varietor kg	mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara
			varieteti i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg	njesia		
	1	2	3	4	5	6
<b>II.B Legominozet</b>						
1	<i>Lotus corniculatus</i> L	tërfili me brirë	ton	1	0.1	40000
2	<i>Lupinus albus</i> L	lupini i bardhë	ton	10	1	40000
3	<i>Lupinus angustifolius</i> L	lupini gjethengushtë	ton	10	1	40000
4	<i>Lupinus luteus</i> L	lupini i verdhë	ton	10	1	40000
5	<i>Medicago lupulina</i> L	Jonxha lupulinë	ton	5	0.3	40000
6	<i>Medicago sativa</i> L	Jonxha	ton	5	0.3	40000
7	<i>Medicago x varia</i> T Martyn	Jonxha e ranishteve	ton	5	0.3	40000
8	<i>Pisum sativum</i> L (partim)	Bizelja	ton	10	2	40000
9	<i>Trifolium alexandrinum</i> L	Tërfili aleksandrin	ton	5	0.2	40000
10	<i>Trifolium hybridum</i> L	Tërfili hibrid	ton	5	0.2	40000
11	<i>Trifolium incarnatum</i> L	Tërfili i kuqërremtë	ton	5	0.2	40000
12	<i>Trifolium pratense</i> L	Tërfili livadhor	ton	5	0.2	40000
13	<i>Trifolium repens</i> L	Tërfili zvarritës	ton	5	0.2	40000
14	<i>Trifolium resupinatum</i> L	Tërfili persian	ton	5	0.2	40000
15	<i>Vicia faba</i> L (partim)	Batha	ton	10	2	40000
16	<i>Vicia pannonica</i> Crantz	Grashina panoneze	ton	10	2	40000
17	<i>Vicia sativa</i> L	Koçkulla	ton	10	2	40000
18	<i>Vicia villosa</i> Roth	Grashina	ton	10	2	40000
<b>II.C Bimë të tjera foragjere</b>						
1	<i>Brassica napus</i> L var <i>napobrassica</i> (L) Rehb	Sinapi	ton	5	0.2	40000
2	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>acephala</i> (DC)	Lakra	ton	5	0.2	40000
3	<i>Phacelia tanacetifolia</i> Benth	Këmbanorja blu	ton	5	0.2	40000
4	<i>Raphanus sativus</i> L. var <i>oleiformis</i> Pers.	Rrepa foragjere	ton	5	0.2	40000
<b>III Panxhari</b>						
1	<i>Beta vulgaris</i> L ssp <i>vulgaris</i> var <i>alba</i> DC	Panxhari	ton	10	0.5	40000
<b>IV Duhani</b>						
1	<i>Nicotiana tabacum</i> L	Duhani	kg	20	0.02	40000
<b>V Pambuku</b>						
1	<i>Gossypium Hirsutum</i> L.	Pambuku	kg	200	0.2	40000
<b>VI Bimët vajore dhe fibroze</b>						
1	<i>Brassica napus</i> L (partim)	Sinapi	kg	200	0.2	40000
2	<i>Brassica nigra</i> (L.) Koch	Lakra e zezë	kg	200	0.2	40000
3	<i>Brassica rapa</i> L var <i>silvestris</i> (Lam.) Briggs	Kolza	kg	200	0.1	40000
4	<i>Cannabis sativa</i> L	Kërpi	kg	50	0.2	40000
5	<i>Glycine max</i> (L.) Merrill	Soja	ton	10	1	40000
6	<i>Helianthus annuus</i> L.	Luledielli	ton	5	1	40000
7	<i>Linum usitatissimum</i> L	Lini	kg	50	0.2	40000
8	<i>Arachis hypogea</i>	Kikiriku	kg	500	1	40000
<b>VII Patatja</b>						
1	<i>Solanum tuberosum</i> L	Patatja	ton	25	1.50	

M

Nr	Emri latinisht	emri në shqip	Tregtimi i materialit mbjellës		mostrat e destinuarat për testim varietor kg	mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara
			varietetit i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg	njesia		
	1	2	3	4	5	6
VIII	<b>Perimet</b>					
1	<i>Allium cepa</i> L	Qepa	kg	10	0.3	40000
2	<i>Allium porrum</i> L	Prasi	kg	10	0.3	40000
3	<i>Allium sativum</i> L	Hudhra	kg	10	0.3	40000
4	<i>Anthriscus cerefolium</i> L. Hoffm.	Fier moskat	kg	10	0.05	40000
5	<i>Apium graveolens</i> L	Selino'	kg	10	0.02	40000
6	<i>Asparagus officinalis</i> L	Asparagusi	kg	10	0.1	40000
7	<i>Beta vulgaris</i> L var <i>vulgaris</i>	Panxhar zakonshëm	kg	200	0.1	40000
8	<i>Beta vulgaris</i> L var <i>conditiva</i> Alef	Panxhar i kuq	kg	200	0.1	40000
9	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>acephala</i> (DC) Alef var <i>sabellica</i> L	Lakra kokë	kg	200	0.3	40000
10	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>botrytis</i> (L) Alef var <i>botrytis</i> L	Lulelakra	kg	200	0.3	40000
11	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>botrytis</i> (L) Alef var <i>cymosa</i>	Brokoli i hollë	kg	200	0.3	40000
12	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>botrytis</i> (L) Alef var <i>italica</i> Plenck	Brokoli kokë	kg	200	0.3	40000
13	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>oleracea</i> var <i>gemmifera</i> DC	Lakra e Brukselit	kg	200	0.3	40000
14	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>capitata</i> (L) Alef var <i>subauda</i> L	Lakra e Savojes	kg	200	0.3	40000
15	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>capitata</i> (L) Alef var <i>alba</i> DC	Lakra kokë bardhë	kg	200	0.3	40000
16	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>capitata</i> (L) Alef var <i>rubra</i> DC	Lakra kokë kuqe	kg	200	0.3	40000
17	<i>Brassica oleracea</i> L convar <i>acephala</i> (DC) Alef var <i>gongylodes</i>	Kolrabi	kg	200	0.3	40000
18	<i>Brassica pekinensis</i> (Lour) Rupr	Lakra kineze	kg	200	0.3	40000
19	<i>Brassica rapa</i> L var <i>rapa</i>	Rilka	kg	200	0.3	40000
20	<i>Capsicum annuum</i> L	Speci	kg	10	0.04	40000
21	<i>Cichorium endivia</i> L	Endivia	kg	5	0.02	40000
22	<i>Cichorium intybus</i> L. (partim)	Çikorja	kg	5	0.02	40000
23	<i>Citrullus lanatus</i> (Thunb) Matsum et Nakai	Shalqini	kg	20	0.3	40000
24	<i>Cucumis melo</i> L	Pjepri	kg	20	0.2	40000
25	<i>Cucumis sativus</i> L	Trangulli	kg	20	0.03	40000
26	<i>Cucurbita maxima</i> L	Kungulli i ëmbël	kg	20	0.3	40000
27	<i>Cucurbita pepo</i> L	Kungulli zakonshëm	kg	20	0.3	40000
28	<i>Cucurbita pepo</i> L var <i>styriaca</i> Greb	Kungulli i verdhë	kg	20	0.3	40000
29	<i>Daucus carota</i> L	Karrota	kg	5	0.1	40000
30	<i>Foeniculum vulgare</i> Miller	Finoku	kg	5	0.02	40000
31	<i>Hybiscus esculentum</i>	Bamja	kg	500	0.5	40000
32	<i>Lactuca sativa</i> L	Sallata	kg	5	0.01	40000
33	<i>Lycopersicon lycopersicum</i> (L.) Karsten ex Farë.	Domatja	kg	1	0.01	40000
34	<i>Petroselinum crispum</i> (Miller) Nyman ex A.ë.Hill	Majdanozi	kg	5	0.01	40000
35	<i>Phaseolus coccineus</i> L	Barbunja	ton	10	3	40000
36	<i>Phaseolus vulgaris</i> L	Fasulja	ton	10	3	40000
37	<i>Pisum sativum</i> L (partim)	Bizelja	ton	5	2	40000

Nr	Emri latinisht	emri në shqip	Tregtimi i materialit mbjellës		mostrat e destinuarat për testim varietor kg	mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara
			varieteti i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg	njesia		
	1	2	3	4	5	6
38	<i>Raphanus sativus</i> L.	Rrepa	kg	5	0.2	40000
39	<i>Solanum melongena</i> L.	Patëllxhani	kg	10	0.05	40000
40	<i>Spinacia oleracea</i> L.	Spinagi	kg	500	0.1	40000
41	<i>Valerianella locusta</i> (L.) Laterr.	Valeriana	kg	50	0.02	40000
42	<i>Vicia faba</i> L. (partim)	Batha	kg	500	4	40000
43	<i>Zea mays</i> L. (partim)	Misri i ëmbël	ton	5	5	40000

IX	<b>Hardhia</b>				fidanë	fidanë
1	<i>Vitis</i> spp	Hardhia	fidanë	10000	20	100*
X	<b>Sumullbari (Humulusi)</b>					
1	<i>Humulus lupulus</i> L.	Sumullbari (Humulusi)	fidanë	5000	20	50*
XI	<b>Bimët drufrutore</b>				fidanë	fidanë
1	<i>Castanea sativa</i> Mill.	Gështenja	fidanë	20000	20	10*
2	<i>Citrus limon</i> (L.) Burm f. lemon	Limoni	fidanë	5000	20	10*
3	<i>Citrus reticulata</i> Blanco	Mandarina	fidanë	5000	20	10*
4	<i>Citrus sinensis</i> (L.) Pers	Portokalli	fidanë	5000	20	10*
5	<i>Citrus x paradisi</i> Macfad	Grapefruiti	fidanë	5000	20	10*
6	<i>Citrus medica</i>	Qitro	fidanë	5000	20	10*
7	<i>Citrus aurantifolia</i> (Christm.) Seing	Nërenxa	fidanë	5000	20	10*
8	<i>Cydonia</i> spp	Ftoi	fidanë	10000	20	10*
9	<i>Cornus mas</i> L.	Thana	fidanë	5000	20	10*
10	<i>Corylus avellana</i> L.	Lajthia	fidanë	30000	20	10*
11	<i>Diospyros kaki</i> L.	Hurma (Kakia)	fidanë	10000	20	10*
12	<i>Fragaria x ananassa</i> Duch	Luleshtrydhja	fidanë	100000	20	10*
13	<i>Ficus carica</i>	Fiku	fidanë	5000	20	10*
14	<i>Zizyphus Zizyphus</i>	Hidja (xinxifja)	fidanë	10000	20	10*
15	<i>Juglans regia</i> L.	Arra	fidanë	100000	20	10*
16	<i>Actinidia</i> sp.	Kivi (Aktinidia)	fidanë	20000	20	10*
17	<i>Malus</i> Mill	Molla	fidanë	20000	20	10*
18	<i>Morus</i> sp.	Mani	fidanë	5000	20	10*
19	<i>Mespilus germanica</i>	Mushmolla dimërore	fidanë	5000	20	10*
20	<i>Eriobotrya japonica</i>	Nespola	fidanë	5000	20	10*
21	<i>Olea europaea</i> L.	Ulliri	fidanë	50000	20	10*
22	<i>Poncirus trifoliata</i>	Trifoljata	fidanë	5000	20	10*
23	<i>Pistacia verra</i> L.	Pistaku	fidanë	5000	20	10*
24	<i>Prunus amygdalus</i> Batsch	Bajamja	fidanë	10000	20	10*
25	<i>Prunus armeniaca</i> L.	Kajsia	fidanë	5000	20	10*
26	<i>Prunus avium</i> L.	Qershia	fidanë	5000	20	10*
27	<i>Prunus cerasus</i> L.	Vishnja	fidanë	5000	20	10*
28	<i>Prunus domestica</i> L.	Kumbulla gjatore	fidanë	5000	20	10*
29	<i>Prunus persica</i> (L.) Batsch	Pjeshka	fidanë	5000	20	10*
30	<i>Prunus salicina</i> Lindl.	Kumbulla japoneze	fidanë	5000	20	10*
31	<i>Pyrus communis</i> L.	Dardha	fidanë	5000	20	10*
32	<i>Punica granatum</i>	Shega	fidanë	20000	20	10*
33	<i>Ribes</i> spp.	Ribes	fidanë	5000	20	10*
34	<i>Rubus</i> spp.	Mjedra	fidanë	5000	20	10*
35	<i>Vaccinium</i> L.	Boronica	fidanë	5000	20	10*

\* Sasi të fidanëve që nevojiten për punë shkencore.

Nr	Emri latinisht	emri në shqip	Tregtimi i materialit mbjellës varieteti i të cilit është në proces për regjistrim në katalog kg		mostrat e destinuara për testim varietor kg	mostrat për qëllime shkencore dhe për ruajtjen e materialit gjenetik fara
			njesia	sasia		
	1	2	3	4	5	6
XII	<b>Bimwt medicinale</b>					
1	Salvia Officinalis	Sherebela	x	x	x	x
2	Thymus Vulgaris	Timus	x	x	x	x
3	Lavandula officinalis	Lavanda	x	x	x	x
4	Origanum Vulgaris	Rigoni	x	x	x	x





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SE KONSUMATORIT

Tiranë, më \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_

**ANEKSI 2**

**KËRKESË PËR TREGTIM TË PËRKOHËSHËM**

Drejtuar: ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

Tiranë

Kërkesë për lejimin e tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, varieteti i të cilit është në proces pranimi për regjistrim në Katalogun Kombëtar.

a. Të dhëna për kerkuesin:

1. <u>Emri e mbiemri i subjektit:</u>
2. <u>Adresa :</u>
3. <u>Nr i licencës:</u>
4. <u>Numri i identifikimit të subjektit:</u>

b. Të dhëna për personin e autorizuar:

5. <u>Emri e mbiemri:</u>
6. <u>Adresa :</u>
7. <u>Numri i dokumentit të identifikimit:</u>

c. Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për të cilin kërkohet leja e tregtimit:

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	Vendi nga importohet *
1						
2						
3						
4						
5						

d. Afati kohor për të cilën kërkohet leja për tregtim: ..... (max 3 vjet)

Për Subjektin:

.....  
Emër/Mbiemër dhe Firma e përfaqësuesit



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE  
MBROJTJES SE KONSUMATORIT

Tiranë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_

**ANEKSI 3**

**KËRKESË PËR AUTORIZIM TË VEÇANTË TË IMPORTIT**

Drejtuar: ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

Tiranë

1. Për pajisjen me autorizim të veçantë të importit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të certifikuar jo përfundimisht dhe/ose, të varietetit i cili është në proces pranimit për regjistrim në Katalogun Kombëtar.  
2. Kërkoj leshimin e autorizimit të importimit të veçantë të materialit të mbjellës dhe shumëzues bimor nga shteti (vendos shtetin nga importohet) \_\_\_\_\_ për arsye (vendos rastet e parashikuara në nenin 26, ligji nr. 10416 datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor").

a. Të dhëna për kerkuesin:

1. Emri e mbiemri i subjektit:  
2. Adresa :  
3. Nr i licencës:  
4. Numri i identifikimit të subjektit:

b. Të dhëna për personin e autorizuar:

5. Emri e mbiemri:  
6. Adresa :  
7. Numri i dokumentit të identifikimit:

c. Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor për të cilin kërkohet autorizim importi:

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	Vendi nga importohet *
1						
2						
3						
4						
5						

d. Afati kohor për të cilin kërkohet leja për tregtim ..... (max. 3 vjet)

Për Subjektin:

.....  
Emër/Mbiemër dhe Firma e përfaqësuesit